



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 968/13 prot.

Datë 26.06.2024

V E N D I M

Nr. 752/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.06.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 646/2024, datë 10.06.2024 për procedurën e prokurimit “E hapur, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 mujor” me nr. REF: 98578-03-18-2024, me objekt: “Shërbim mirëmbajtje për impiantet e ngrohjes në objektet arsimore dhe Publike”, me fond limit 24 106 880 (njëzet e katër milion e njëqind e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) Lekë, pa TVSH, zhvilluar me datë 03.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “SULLOLLARI-KLIMA” SHPK me NIPT K01529003M dhe adresë Tiranë, Rruga “Muhamet Gjollesha”, 71/3, Kati I.

BOE “ONI” SHPK me NIPT J66902008N dhe adresë Lagjja “Vasil Shanto”, Rruga “Hydajet Lezha”, Nr.32, Shkodër & “CARA” SHPK me NIPT K07729920F dhe adresë Dibër, Burrel, Lagjja “Pjeter Budi”, Rruga “Abdi Mati”, Ndërtesë private Nr.10.

Subjekt i interesuar:

Operatori ekonomik “CLIMACASA” SHPK me NIPT L07805502F dhe adresë Shqipëri, Lezhë, Lagjja

“Besëlidhja”, Rruga "Shtraus", Pallati Nr. 1, kati përdhe, Njësia me numër pronësie 5/82-N1, ZK Nr. 863.

Operatori ekonomik “SULLOLLARI-KLIMA” SHPK me NIPT K01529003M dhe adresë Tiranë, Rruga "Muhamet Gjollësia 71/3, Kati 1.

Operatori ekonomik “KEVIN KONSTRUKSION” SHPK me NIPT K71401004Ë dhe adresë Tiranë, Rruga “Adem Jashari”, Ndërtesa 4, Hyrja 10, Njësia Bashkiake Nr.5.

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë me adresë Rruga “5 Maji”, Godina 17, Tregu i Medresesë, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 10.06.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 646/2024, ku vendosi:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “SULLOLLARI-KLIMA” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 mujor” me nr. REF: 98578-03-18-2024, me objekt: “Shërbim mirëmbajtje për impiantet e ngrohjes në objektet arsimore dhe Publike”, me fond limit 24 106 880 (njëzet e katër milion e njëqind e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 03.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ONI” SHPK & “CARA” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të kualifikojë operatorin ekonomik “SULLOLLARI-KLIMA” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
4. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “ONI” SHPK & “CARA” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

6. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “SULLOLLARI-KLIMA” SHPK.
7. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ONI” SHPK & “CARA” SHPK.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 2662 prot., datë 21.06.2024, protokolluar me tonën nr. 968/10 prot., datë 25.06.2024 autoriteti kontraktor, njofton se: [.....Ju njoftojmë se në zbatim të Vendimit Nr. 646/2024 datë 10.06.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, protokolluar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike me datë 13.06.2024 me nr. 2564, në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbim mirëmbajtje për impiantet e ngrohjes në objektet arsimore dhe Publike”, me fond limit 24 106 880 (njëzet e katër milion e njëqind e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) Lekë, pa TVSH, të publikuar me datë 19.03.2024, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon: Autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë, ka realizuar rivlerësimin e ofertave përkatëse në sistemin e publikimeve elektronike (SPE) sipas dispozitivit të këtij vendimi”.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 2662 prot., datë 21.06.2024, protokolluar me tonën nr. 968/10 prot., datë 25.06.2024 autoriteti kontraktor, njofton se: [.....Ju njoftojmë se në zbatim të Vendimit Nr. 646/2024 datë 10.06.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, protokolluar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike me datë 13.06.2024 me nr. 2564, në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbim mirëmbajtje për impiantet e ngrohjes në objektet arsimore dhe Publike”, me fond limit 24 106 880 (njëzet e katër milion e njëqind e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) Lekë, pa TVSH, të publikuar me datë 19.03.2024, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon: Autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë, ka realizuar rivlerësimin e ofertave përkatëse në sistemin e publikimeve elektronike (SPE) sipas dispozitivit të këtij vendimi”.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi veprimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, lidhur me zbatimin e vendimit Nr. 646/2024, datë 10.06.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga ky verifikim rezultoi se, autoriteti kontraktor kreu rivlerësimin në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) të ofertave, duke korrigjuar arsyet e skualifikimit për bashkimin e operatorëve ekonomikë, “ONI” SHPK & “CARA” SHPK, në zbatim të vendimit të KPP Nr. 646/2024/2024, datë 10.06.2024.

Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit të sipërcituar, duke e kualifikuar operatorin ekonomik “SULLOLLARI-KLIMA” SHPK, në zbatim të vendimit të KPP Nr. 646/2024/2024, datë 10.06.2024.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*E hapur, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj*” me nr. REF: 98578-03-18-2024, me objekt: “Shërbim mirëmbajtje për impiantet e ngrohjes në objektet arsimore dhe Publike”, me fond limit 24 106 880 (*njëzet e katër milion e njëqind e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë*) Lekë, pa TVSH, zhvilluar me datë 03.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

